# DËSHMI ARKIVI

**A-450259**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kosova luan katër herë brenda 10 ditësh, Foda përballet me disa mungesa para grumbullimit |
| ADRESA | `https://albeu.com/sport/kosova-luan-kater-here-brenda-10-ditesh-foda-perballet-me-disa-mungesa-para-grumbullimit/1014948/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 18:37:50 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 18:32:59 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `9947a1d6ead37f8dba18fb35396e8284f53e8be0f13938bbe35d450b4146cb4b` |
| TEKSTI | `8108f1d1eb16fcd45d3ff3356dad90ded6634ac642de7004df1e564e05f3b3cf` |
| PAMJA | `ff7e18a2ea011b7f7692ca2aa64ecd551bf468e4f3665730bc81ec1d7e6a3db1` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ca178da4f57816630e2e62975c40cff9605e39fe6c230e697004b6791cdcbf25` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `78d6084bfd6cb1be1efaeb014ade0ef1539709e636c33f39308264a405fee6e2` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ca178da4f57816630e2e62975c40cff9605e39fe6c230e697004b6791cdcbf25`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Kosova luan katër herë brenda 10 ditësh, Foda përballet me disa mungesa para grumbullimit



Kosova do ta hapë më 24 shtator ciklin kualifikues në Ligën B të Ligës së Kombeve, duke e pritur Irlandën në Prishtinë.

Tri ditë më vonë, më 27 shtator, "Dardanët" do të udhëtojnë në Austri për t'u përballur me kombëtaren vendase. Më 1 tetor është planifikuar ndeshja kundër Izraelit në Hungari, ndërsa seria prej katër takimesh do të përfundojë më 4 tetor në Prishtinë, ku Kosova do të luajë sërish ndaj Austrisë.

Ky kalendar i ngjeshur, me katër ndeshje brenda dhjetë ditësh në fund të shtatorit dhe fillim të tetorit, e bën gjendjen fizike të futbollistëve një element të rëndësishëm në përzgjedhjet e Franco Fodës.

Përzgjedhësi i Kosovës pritet të përballet me disa mungesa gjatë këtij grumbullimi. Amir Rrahmani nuk do të jetë në dispozicion, pasi ka vendosur ta pezullojë angazhimin me kombëtaren pas mosmarrëveshjeve me FFK-në, të cilën edhe e ka paditur.

Rrahmani nuk është problemi i vetëm në repartin defensiv. Kreshnik Hajrizi gjithashtu pritet të mungojë me siguri, pasi u dëmtua në maj dhe më pas iu nënshtrua një operacioni.

Hajrizi nuk është rikuperuar ende plotësisht dhe, sipas Telegrafit, pritet të mos luajë në asnjërën prej katër ndeshjeve të Ligës së Kombeve.

Edhe Elvis Rexhbeçaj pritet të mbetet jashtë listës. Mesfushori pësoi një lëndim disa muaj më parë gjatë një seance stërvitore me Wolfsburgun dhe ende nuk është kthyer plotësisht në dispozicion.

Një tjetër mungesë me peshë mund të jetë ajo e Florent Muslijës. Mesfushori vazhdon rikuperimin nga dëmtimi në gju dhe nuk ka luajtur që prej 24 prillit.

Disponueshmëria e tij për këto takime do të varet nga ecuria e gjendjes së tij fizike.

të fundit/


Serafimovski: Mbi 54 milionë kilogramë rrush janë dorëzuar në…


Kosova luan katër herë brenda 10 ditësh, Foda përballet me disa…


Protesta e 109-të para Kryeministrisë: "Vendimi i Hagës nuk…


Protestuesit kundërshtojnë vendimin e Speciales dhe…


AFA reagon ndaj aktgjykimit: Serbia ishte agresorja, Kosova…


Mushkolaj kërkon mobilizim të fuqishëm të shtetit në fazën e…


Berisha kundërshton vendimin për ish-krerët e UÇK-së: Dënime të…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Pikëpyetje ka edhe rreth Fisnik Asllanit, i cili vetëm së fundmi është kthyer pas lëndimit. Sulmuesi u aktivizua për disa minuta në ndeshjen e fundit të Hoffenheimit kundër Stuttgartit, por pas dëmtimit në gju mund të mos ketë arritur ende formën optimale për ta përballuar ngarkesën e katër ndeshjeve.

Një situatë më vete paraqet edhe Milot Rashica. Sulmuesi ka luajtur shumë pak minuta gjatë këtij sezoni, për shkak se te Besiktasi nuk po e gjen hapësirën që dëshiron.

Për rrjedhojë, mbetet e paqartë nëse Rashica do të përfshihet në listën e Kosovës për grumbullimin e ardhshëm.

Lista e futbollistëve do të bëhet publike të premten.

Shtuar më 16.09.2026 20:32

Tags: Elvis Rexhbeçaj , florent muslija , franco foda , Kombëtarja e kosovës , Kreshnik Hajrizi




VIDEO/ Goditje spektakolare nga mesi i fushës, 23-vjeçari i…



Arda Güler transformohet te Real Madridi, shton 12 kilogramë masë muskulore




Vllaznia kërkon reagimin në "Loro Boriçi", klubi njofton tifozët për çmimet e…



Katër lojtarë jashtë për Ligën e Kombeve, Maran shpall të premten listën e…



Brighton vendos rekord historik në Ligën Premier me lojtarë nga 15 kombësi



Dënimi me 81 vite burg nga Gjykata e Hagës, Vora mbështet ish-drejtuesit e…



Klopp përgatit surprizën e parë te Gjermania, fton futbollistin që 15 muaj më…




Kategoria e Parë zbret në fushë me 6 ndeshje, ja rezultatet LIVE të javës s…

© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko… Kërko

**Kryesore**
- Erion Veliaj
- Free Esim
- Zgjedhjet 2025
- Belinda Balluku
- SPAK
- Kombëtarja

**Kategori**
- Lifestyle
- Showbiz
- Tech
- Shëndetësi
- Argetim
- Enciklopedi

**Linqet**
- Live tv shqiptare
- Moti në Shqipëri
- Travel
- Horoskopi
- Livescore
- News from Albania

**Tags**
- Edi Rama
- Albania News
- Ilir Meta
- Piranjat
- gazeta, tv, portale
- Sali Berisha

**Moti**
- Moti në Tiranë
- Moti në Prishtinë
- Moti në Shkup
- Moti në Durrës
- Moti në Prizren
- Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com |

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.